

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d) nenit 49 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e RK-së", nr.28/2008), nenit 13 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 të datës 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e dytë të rregullt, e mbajtur më datën 11.03.2026, merr këtë:

VENDIM NR.05/2026/KG

për miratimin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit, e mbajtur më datën 10.02.2026

Neni 1

Miratohet procesverbali nga mbledhja e parë e rregullt e Kuvendit Komunal, e mbajtur më datën 10.02.2026.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është procesverbali nga mbledhja e parë e rregullt e Kuvendit Komunal, e mbajtur më datën 10.02.2026.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi 30 ditë pas dorëzimit tek autoriteti mbikëqyrës në kuptimin e nenit 8 lidhur me nenin 9 të Ligjit nr. 08/L-284 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Milan Dimitrijević





PROCESVERBALI

Nga mbledhja e parë e rregullt e Kuvendit të Komunës së Graçanicës

E mbajtur më datën 10.02.2026 në sallën e Kuvendit të Komunës së Graçanicës dhe filloi me punë në orën y 11:00.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Graçanicës, Millan Dimitrijeviq, hapi mbledhjen duke i përshëndetur të gjithë të pranishmit dhe shtoi se në mbledhje nga 19 këshilltarë morën pjesë 17 këshilltarë dhe se ka kuorum, ndërsa mungojnë 5 këshilltarë: Dejan Jevtiq dhe Marija Steviq. Në mbledhje morën pjesë: përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësuesit e KFOR-it, mediat, Shërbimi i Përkthimit, Shërbimi i Informimit dhe Shërbimi për Çështjet e Kuvendit.

Kryesuesi i njoftoi këshilltarët se para mbledhjes së sotme të Kuvendit u mbajt mbledhja e parë e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe se komiteti njëzëri e ka dhënë mendimin pozitiv për rendin e ditës të propozuar me plotësimin e tij me një pikë: „Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për themelimin e Komisionit të Etikës së Komunës së Graçanicës, me propozim të kryesuesit të KK të Graçanicës, Millan Dimitrijeviq”.

Kryesuesi i Kuvendit të komunës hodhi në votim rendin e propozuar të ditës me plotësimin e tij.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Komiteti njëzëri, me votat e 17 këshilltarëve “Pro”, miratoi rendin e mëposhtëm të ditës:

1. Dhënia e betimit nga këshilltari i sapoemëruar i Kuvendit të komunës.
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e jashtëzakonshme, e mbajtur më datën 30.12.2025.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes publike-komunale “Ekologjia” Sh.A. Graçanicë, me propozimin e kryetarit të Komunës së Graçanicës, Novak Zhiviq.
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Graçanicës për vitin 2026, me propozimin e kryesuesit të KK të Graçanicës, Millan Dimitrijeviq.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për themelimin e Komisionit të Etikës së Komunës së Graçanicës, me propozim të kryesuesit të KK të Graçanicës, Millan Dimitrijeviq.
6. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1. Dhënia e betimit nga këshilltari i sapoemëruar i Kuvendit të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të komunës e ftoi këshilltarin e sapoemëruar të Kuvendit që ta lexonte tekstin edeklaratës solemne dhe ta nënshkruantë atë.

„Unë, Albert Vllahu, deklaroj solemnisht se do t'i kryej me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtroj autorizimet e mia si këshilltar i kuvendit të Komunës së Graçanicës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë”.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dytë e jashtëzakonshme, e mbajtur më datën 30.12.2025.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 17 këshilltarëve “Pro”, miratoi pikën e dytë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për emërimin e anëtarëve të Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes publike-komunale “Ekologjia” Sh.A. Graçanicë, me propozimin e kryetarit të Komunës së Graçanicës, Novak Zhiviq.

Kryesuesi shpjegoi se një anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve emërohet nga kryetari i komunës, ndërsa dy anëtarë të tjerë duhet të jenë nga radhët e këshilltarëve të Kuvendit të komunës. Duke marrë parasysh se shumica e këshilltarëve nga partitë opozitare përfaqësohen në komitete, përveç këshilltarit Vllahu, i cili tani e ka nënshkruar deklaratën solemne, të udhëhequr nga ky fakt, janë propozuar këshilltarët e mëposhtëm: Marija Steviq dhe Dejan Bozhidareviq, dhe Sasha Daniq janë propozuar nga kryetari i Komunës së Graçanicës.

Këshilltari i Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Albert Vllahu, para partisë “Aleanca Shqiptare”, pyeti nëse mund t'i sigurohet Statuti i NPK “Ekologjia”.

Kryesuesi u përgjigj se mund të sigurohet, por shpjegoi se ky komision është organ mbikëqyrës para vetë komunës dhe nuk ka të bëjë fare me menaxhimin e vetë Ekologjisë. Anëtarët e propozuar të komisionit janë të detyruar ta njoftojnë Kuvendin e komunës dhe të jenë një lidhje midis Kuvendit dhe vetë ndërmarrjes.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me votat e 16 këshilltarëve “Pro” dhe 1 votë “Abstenim” të këshilltarës Lumnije Gashi (për shkak të konfliktit të interesit nuk ka votuar, sepse është e punësuar në Ekologjinë), miratoi pikën e tretë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Graçanicës për vitin 2026, me propozimin e kryesuesit të KK të Graçanicës, Millan Dimitrijeviq.

Kryesuesi shpjegoi se Plani i punës së Kuvendit të komunës miratohet çdo vit për çdo muaj, por bëhet fjalë për një plan kornizë të punës. Ne nuk i përmbahemi në mënyrë strikte planit, sepse nëse drejtori nuk mund ta paraqesë raportin për muajin për të cilin ishte planifikuar, atëherë ai raport shtyhet për një mbledhje pasuese, sepse ne praktikojmë që drejtorët e drejtorive ta shpjegojnë personalisht raportin, jo një nga punonjësit e drejtorisë.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 17 këshilltarëve “Pro”, miratoi pikën e katërt të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për themelimin e Komisionit të Etikës së Komunës së Graçanicës, me propozim të kryesuesit të KK të Graçanicës, Millan Dimitrijeviq.

Kryesuesi shpjegoi se Komisioni i Etikës zgjidhet në fillim të çdo mandati të Kuvendit të ri të komunës.

Për anëtarë të Komisionit të Etikës emërohen personat e mëposhtëm:

1. Ljubisha Karaxhiq (*Ljubisha Karadžić*), anëtar (propozim nga radhët e anëtarëve të Kuvendit Komunal)
2. Milla Zhivković (*Mila Živković*), anëtare (propozim nga radhët e anëtarëve të Kuvendit Komunal)
3. Brankica Niçiq (*Brankica Ničić*), anëtare (propozim nga radhët e personave të emëruar)
4. Nebojša Rashiq (*Nebojša Rašić*), anëtar (propozim nga radhët e qytetarëve me integritet)
5. Ljubomir Maksimović (*Ljubomir Maksimović*), anëtar (propozim nga radhët e qytetarëve me integritet)

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me votat e 15 këshilltarëve “Pro” dhe 2 vota “Abstenim” të këshilltarëve, Ljubisha Karaxhiq dhe Nikolla Rashiq, miratoi pikën e pestë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Të ndryshme.

Këshilltarja e Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Aida Qerkini, para partisë “Aleanca Shqiptare”, shpjegoi kërkesën e qytetarëve të vendbanimit “NIC” të drejtuar kryetarit të Komunës së Graçanicës, kryesuesit të Kuvendit të komunës dhe nënkryetarit të komunës për Komunitete, në lidhje me emërtimin e rrugëve. Propozoj që në rendin e ditës të mbledjes së ardhshme të Kuvendit të përfshihet pika për emërtimin e rrugëve, sepse ka shumë rrugë që nuk kanë emra dhe të formohet komisioni për t'u marrë me këtë çështje.

Kryesuesi u përgjigj se kërkesa duhet të paraqitet përmes arkivit. Ai shpjegoi se në mandatin e kaluar, ata kishin pasur kërkesa për ndryshimin e emrit të 6-7 rrugëve si dhe se kërkesa iu është dërguar ministrisë kompetente, por e njëjta e ka refuzuar ndryshimin e emrave të rrugëve sepse emrat e rrugëve ndryshohen për një periudhë ligjore prej 10 vitesh.

Këshilltarja e Kuvendit të komunës, Aida Qerkini, para partisë “Aleanca Shqiptare”, shpjegoi se kishte një kërkesë nga qytetarët e vendbanimit “NIC” të datës 17.09.2022 për emërtimin e rrugëve dhe rrugët janë emëruar. Ajo dha një shembull kur qytetarët po kërkonin disa dokumente në Komunën e Graçanicës dhe vunë re se emri i një rruge ishte ndryshuar.

Kryesuesi tha se ata duhet ta dërgojnë kërkesën edhe në Drejtorinë e Urbanizmit dhe kur ta pranojnë kërkesën, sigurisht që do të kërkojnë një përgjigje nga Drejtoria e Urbanizmit dhe do ta merrni një përgjigje për këtë çështje në mbledhjen e ardhshme.


Këshilltarja e Kuvendit të Komunës së Graçanicës, Aida Qerkini, para partisë “Aleanca Shqiptare”, pyeti a do të përfshihet në mbledhjen e ardhshme e Kuvendit pika për emërtimin e rrugëve që nuk janë emëruar.

Kryesuesi u përgjigj se duhet ta marrin kërkesën nga qytetarët, e cila do të kalojë nëpër arkiv dhe në bazë të kërkesës në fjalë është e nevojshme të formohet komisioni.


Pasi që askush nuk e mori fjalën për të diskutuar lidhur me pikën “Të ndryshme” të rendit të ditës, kryesuesi falënderoi për bashkëpunim dhe mbledhja mbaroi në orën 11:20.

Procesmbajtësi:

Agron Karadollami



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Milan Dimitrijević